



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 572 prot.

Tiranë, më 22. 05 . 2020

Lënda: Kthim përgjigje mbi përputhshmërinë e legjislacionit të brendshëm me Konventën mbi Dhunën dhe Ngacmimin (C-190, 2019) dhe të Rekomandimin Mbi Dhunën dhe Ngacmimin (R-206, 2019), para ratifikimit të tyre.

**Z. ARIAN KRAJA
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**

*Në vëmendje të: Drejtorisë së Politikave të Punësimit dhe Aftësimit Profesional
Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit Ekonomik dhe Punësimit*

Adresa: Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Nr.3

TIRANË

Inderuar z. Sekretar i Përgjithshëm,

Në vijim të shkresës Tuaj Nr. 8118 Prot, datë 11.05.2020, Komisioneri për Mbrotjen nga Diskriminimi është vënë në dijeni mbi iniciativën për ratifikimin e Konventës mbi Dhunën dhe Ngacmimin (C-190, 2019) dhe të Rekomandimit Mbi Dhunën dhe Ngacmimin (R-206, 2019) të Organizatës Ndërkombëtarë të Punës, dhe kërkesën për informacion dhe mendime nëse legjislacioni ynë i brendshëm është në përputhje me parashikimet e kësaj Konverte dhe ndryshimet e nevojshme ligjore, nëse është e nevojshme.

Paraprakisht, dëshirojmë të theksojmë se, Komisioneri përgëzon nismën e ndërmarrë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për ratifikimin e këtyre akteve të Organizatës Ndërkombëtarë të Punës, të cilat besojmë se do të ndikojnë në rritjen e standarteve ligjore dhe garancive në fushën e mbrojtjes nga dhuna dhe ngacmimi të punëtorëve dhe personave të tjerë në punësim, përfshirë ato me bazë gjinore.

Komisioneri për Mbrotjen nga Diskriminimi, pasi u konsultua me këto dy akte, parashtron mendime, brenda fushës së veprimtarisë dhe mandatit të tij, si më poshtë vijon:

origjinal në anglisht është “*Harassment*”, ndërkokë që në përkthimin zyrtar jepet termi “*Ngacmim*”. Në Kodin e Punës, brenda nenit 32, jepet herë termi “*Shqetësim*” dhe herë ai “*Ngacmim*”, si edhe termat “*ngacmim moral dhe seksual*” dhe “*shqetësim seksual*”. Po kështu, edhe Ligji 9970/2008 “*Për Barazinë Gjinore në Shoqëri*”. Ndërsa, në Ligjin 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*” jepet vetëm termi “*Shqetësim*” dhe “*Shqetësim seksual*”.

Për ta pasur në konsideratë në kuadër të përputhshmërisë, sjellim në vëmendjen Tuaj rëndësinë e unifikimit të termave “*Shqetësim*” dhe “*Ngacmim*”, në legjislacionin e brendshëm shqiptar, të cilat përkijnë me termin “*Harassment*” në anglisht, përfshirë edhe në dy aktet për të cilat po japim mendim. Mesa duket kjo është një çeshtje përkthimi, në kuptimin e teknikës legjislative, por që mund të çojë edhe në të kuptuarit dhe të interpretuarit e ndryshëm të të njëjtit koncept.

*Rekomandojmë që, nëse do këtë iniciativë ligjore për ndryshimin e legjislacionit të brendshëm në kuadër të përputhshmërisë, por edhe në aktet në fjalë, të përkthyera nga shërbimi zyrtar, të merret parasysh unifikimi i termave “*Shqetësim*” dhe “*Ngacmim*”, në mënyrë që të mos krijohen paqartësi dhe gabime në të kuptuarit dhe të interpretuarit e ndryshëm të të njëjtit koncept. Në këtë kuadër, KMD sugjeron përdorimin e unifikuar të termit “*Shqetësim*”, si në legjislacionin e brendshëm ashtu edhe në tekstin e Konventës 190 dhe Rekomandimit 206, 2019 të ILO-s, me qëllim ndreqjen para ratifikimit.⁶*

II) Në lidhje me mbrojtjen nga “*Dhuna*” në punësim

Konstatojmë se Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë nuk parashikon në asnje dispozitë, në mënyrë eksplikite, mbrojtjen nga “*Dhuna*”, sipas kuptimit të kësaj Konverte. Kështu, ky Kod njeh vetëm “*ngacmin*” dhe “*shqetësim*”, përfshirë atë seksual dhe me bazë gjinore, për sa u sqarua më lart.

Gjithashtu, Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*” nuk e parashikon “*Dhunën*”, sipas kuptimit të kësaj Konverte.

Në këndvështrimin tonë, *Konventa mbi Dhunën dhe Ngacmin* (C-190, 2019) parashikon mbrojtjen nga “*Dhuna dhe Ngacimi*” në mënyrë kumulative. Kështu, kjo Konventë ka si qëllim mbrojtjen e punëtorëve dhe personave të tjera në botën e punës, nga dhuna dhe ngacimi, përfshirë ato me bazë gjinore.

Konkretisht, në përkufizimin e termit “*dhunë dhe ngacim*” sipas nenit 1 të Konventës, ka elementë të cilat nuk përfshihen në përkufizimin e termit “*Shqetësim*” sipas legjislacionit të brendshëm, si: - “*sjellje e padëshiruar*” në krahasim me “*gamë sjelljesh dhe praktikash të papranueshme*”; - elementi i “*kërcënimeve*”; fakti nëse kjo ndodhi është e vetme ose e përsëritur dhe; - elementi i pasojës nga “*cënimi i dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjetidi*

⁶ Duke patur parasysh se dy aktet e derguara per mendim, përkthimi nga shërbimi zyrtar është “*Ngacmim*”.

frikësues, armiqësor, përçmues, poshtërues a ofendues" ne krahasim me "dëm fizik, psikologjik, seksual pse ekonomik".

Sa më lart, *Komisioneri vlerëson se nuk ka një përputhshmëri të plotë të legjislacionit tonë të brendshëm me konceptet dhe garancitë që ofron kjo Konventë mbi mbrojtjen nga dhuna, përfshirë atë me bazë gjinore, të punëtorëve dhe personave të tjerë në botën e punës.*

Rekomandojmë që, të bëhen ndryshimet e nevojshme ligjore në Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë, me qëllim shtimin e parashikimit për mbrojtjen nga dhuna, përfshirë atë me bazë gjinore, të punëtorëve dhe personave të tjerë në botën e punës, përpara ratifikimit të Konventës mbi Dhunën dhe Ngacmimin (C-190, 2019) nga Shteti Shqiptar, në kuadër të përputhshmërisë.

III) Në lidhje me mandatin e kërkuar nga organet e barazisë

Rekomandimi Mbi Dhunën dhe Ngacmimin (R-206, 2019) parashikon në paragrafin 21 të tij ose në Kreun III "Zbatimi, mjetet juridike dhe ndihma", shprehimisht se:

"Mandati i organeve kombëtare përgjegjëse për inspektimin e punës, sigurinë dhe shëndetin në punë, dhe barazinë dhe mos-diskriminimin, duke përfshirë barazinë gjinore, duhet të mbulojë dhunën dhe ngacmimin në botën e punës".

Sa më lart sqaruam, ligji organik të cilin ka për detyrë që të mbikëqyrë dhe zbatojë Komisioneri për Mbrotjen nga Diskriminimi, si institucioni përgjegjës për barazinë dhe mos-diskriminimin në Shqipëri, nuk parashikon mandat për këtë institucion për mbrojtjen nga dhuna të punëtorëve dhe personave të tjerë në botën e punës.

Në përfundim, Komisioneri vlerëson përcjelljen e këtyre akteve për mendim, para ratifikimit, me qëllim analizën e përputhshmërisë së legjislacionit të brendshëm, përsa i takon fushës së veprimitarisë tonë, dhe duke shpresuar që të kemi qenë sa më të quartë dhe shteresë në informacion, mbetemi të gatshëm për çdo mendim ose bashkëpunim tjetër të mëtejshëm në funksion të këtij qëllimi.

Me respekt,

